



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT			
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE			
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY			
Mësimi Org.	AQP	Nr. Prot.	39/22
Org. Jeshme		Org. Prot.	
Org. Unit		Prot. No.	
Nr. I Faneve	11/32	Data :	21.07.2022
Bë Struktura		Date :	
No. Pages			
Përshtet /			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i
transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIM ME KARBURANTE – NIVELI QENDROR

LOT 4 - FURNIZIM ME KARBURANTE PËR NXEHMJE DHE
GJENERATOR PËR NEVOJAT E INSTITUCIONEVE TË NIVELIT
QENDROR

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-22-3398-1-1-1

NUMRI I BRENDSHËM I PROKURIMI: AQP-22-005-111

NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-22-3398-1-1-1/C251

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT, Ndërtesa e ish-Gërmisë Kati IV zyra A 403, Prishtinë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

N.T. „Fer-Petroll Terstenik-Glllogoc, Glllogoc, (në vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Titulli i kontratës: Furnizim me karburante – Niveli Qendror

Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje dhe gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Furnizim me karburante për nxehmje dhe gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror të paraqitura në Aneksin 7.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për Autoritetet kontraktuese të paraqitura në Aneksin 7.

1.2 Për furnizim me karburante për gjenerator dhe ngrohje kjo kontratë publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që AK tenton të blejë karburante për gjenerator apo nxehmje, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **13.08.2022** dhe përfundon në datën **12.08.2023**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim të karburantit për gjenerator dhe nxehmje është 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhrer blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit me karburante për gjenerator dhe nxehmje do të jenë pikat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktuese të paraqitura në Aneksin 7.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Ne	Lloji i karburantit	Premiumi për një litër
1	Naftë	0.0299€/litër
2	Benzinë	0.0299€/litër

Vlera totale e parashikuar e kontratës është **2,976,473.58€** (dy milion e njëqindeshtatëdhjetëgjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë euro e pesëdhjetë cent) sasia totale indikative e kontratës është 2,000,000 litra. Çmimi për Premium është 0.0299€/litër apo 59,800€ për totalin indikativ të litrave. Devijimi i lejuar është +/-30% i sasisë së litrave (2,000,000) apo i çmimit total indikativ të Premiumit (59,800€).

4.2 Çmimi i premiumit është fiks dhe nuk ndryshon ndërsa çmimi për litër të karburantit është variabil. Kalkulimi i çmimit gjatë realizimit të kontratës bëhet duke u bazuar në çmimin mesatar mujor të berzës së Plattit CIF Med (Genova/Lavera), kursit mesatar mujor të Bankës Qendrore Evropiane dhe elementeve tjera fikse dhe variabile që janë pasqyruar në Aneksin 10 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve që është pjese e kësaj kontrate.

4.3 Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje në berzë dhe bënë kalkulimin e çmimit në baza mujore duke u bazuar në tabelën e formimit të çmimeve. Autoriteti Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit, më së largu deri me datën pesë (5) të muajt vijues dërgon të Furnizuesi kalkulimin e çmimeve për muajin paraprak dhe publikon çmimet në ueb faqe. Obligohet Furnizuesi që më së largu deri me datën dhjetë (10) të muajt vijues ti dërgojë të gjitha faturat për shpenzimet e karburanteve për muajin paraprak tek të gjitha AK që kanë shfrytëzuar këtë kontratë, faturat duhet të dërgohen tek secili AK për shpenzimet e atij AK. Agjencia Qendrore e Prokurimit. Këtë vendim të formimit të çmimeve të publikuar në ueb faqen e AQP-së kanë të drejtë ta shfrytëzojnë vetëm Autoritetet Kontraktuese që janë shfrytëzues të kësaj kontrate kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit;
- (e) Aneksi nr. 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme;
- (f) Aneksi nr. 7 - Lista e Autoriteteve Kontraktuese;
- (g) Aneksi nr. 10 - Tabela e formimit të çmimeve;
- (h) Aneksi nr. 11 - Pikat e shpërndarjes së Autoriteteve Kontraktuese

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Mehmet Rama	Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	21.07.2022	Data:	21.07.2022
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	PSHAR GJOKI
Pozita:	MANA PUORI
Nënshkrimi:	
Data:	21-07-2022
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Produktet**" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "**Autoriteti Kontraktues**" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "**Furnizues**" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "**Palë(t)**" do të thotë nënshkruarit e kontratës.

1.6 "**Inkotermet**" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "**Furnizim**" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "**Shërbimet pas shitjes**" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "**KPK**" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "**KVK**" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të

kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktun pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njej lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jene të siguruara plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të

Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të bëhen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoje një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrat për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve

përmbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohej se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalojnë personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizuesi do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizuesi mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimi derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimi të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimi, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës

furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;

d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguheshin ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimi, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimi përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimi të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose

b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose

c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të

vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përpunuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.

- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkaktonte kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha që do të përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Autoritetet kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë, brenda 5(pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës Secili Autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë do të emërojë një përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit i cili do të jetë në dispozicion çdoherë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin për të marr vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Kërkohet nga Furnizuesi që të marr nënshkrimet e pranimit të karburanteve / të lëshojë kuponin e karburantit dhe/apo fletën e të dhënave nga i gjithë personeli i autorizuar të cilët marrin karburantet për gjeneratore, nxehmje, etj. Nevojiten të dhënat në vijim: Data dhe koha e lëshimit Emri i entitetit, departamentit, seksionit, njësisë pranuese Emri, mbiemri dhe numri i identifikimit të individit që pranon furnizimin Lloji i karburantit Barkodin e gjeneratorit , numrin serik dhe lexuesin e "orëve të punës" (kurdo që është i pajisur) ose për nxehmje vendi i saktë i pikës ku është bërë dërgimi i karburantit Sasinë (në litra) të karburantit. Furnizuesi, në baza 3 mujore, do të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e karburanteve të dorëzuara tek secili autoritet Kontraktues, në 3 mujorin e fundit të kontratës Furnizuesi duhet të raportoj në baza 1 mujore. Një fletë e veçantë duhet të përgatitet për secilin Autoritet Kontraktues. Raporti duhet minimum të paraqes: sasinë e karburanteve të dorëzuara Llojin e karburanteve;

		Agjencia Qendrore e Prokurimit do te hartoj një model te Raportit dhe do ta dërgoj te Furnizuesi jo me vone se 20 dite nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi qe ta shfrytëzoj ketë model te Raportit gjate raportimit te AQP-ja. AQP ka të drejt te kërkoj nga kontraktuesi raportime më të shpeshta dhe kjo do të jetë obligim për kontraktuesin. Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e Furnizuesit, i lejon AQP-në që të marrë masa, siç është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshuarja e Referencës negative për kontratën e nënshkruar.	
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.2	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar ne Aneksin 7.
Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit. Kontraktuesi do të emëroj një përfaqësues, i cili do të veproj si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet qe lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet te jete ne dispozicion çdo here qe kërkohet dhe do te ketë autoritetin e duhur për te marre vendime te shpejta dhe te zgjidhe çështjet qe lidhen me ekzekutimin e kontratës. Ne raste te caktuara nëse për shkak te skadimit te validitetit te licencave te shitjes me pakice te pikave te karburantit të nen kontraktuara, ne rast te shkëputjes se marrëveshjeve te nen kontraktimit apo ne rast te hapjes se ndonjë pike te re te karburantit qe ka ne pronësi apo te marr me qira, Furnizuesi ka te drejtën qe ta ndërroj piken e furnizimit me paralajmërim ne afat prej 10 ditëve te Agjencisë Qendrore te Prokurimit dhe te gjitha Autoritetet Kontraktuese qe shfrytëzojnë kontratën te specifikuar ne Aneksin nr. 7.
Siguria ekzekutimit	e	8.1	Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do te dorëzoj tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 297,648.00€ për kohëzgjatje prej 13 muajsh nga data e hyrjes ne fuqi te kontratës.
Periudha ekzekutimit detyrave	e të	12	Kurdo qe ndonjëri nga Autoritetet Kontraktuese pale te kësaj kontrate dëshirojnë qe te blejnë derivate për gjeneratorë apo për ngrohje sipas kësaj kontrate, duhet qe te dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit		13	Autoriteti Kontraktues ne nenin i referohet cilitdo autoritet kontraktues te identifikuar ne Aneksin 7 zgjatja e periudhës së ekzekutimit lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Vonesat ekzekutim	ne	14	Autoriteti Kontraktues ne nenin 14.1 dhe 14.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues te identifikuar ne Aneksin 7.
Suspendimi		15	Autoriteti Kontraktues ne nenin 15 i referohet cilitdo autoritet kontraktues te identifikuar ne Aneksin 7.
Cilësia furnizimeve	e	16.1	Autoritetet Kontraktuese te cilat janë te identifikuar ne Aneksin 7 kanë te drejte te refuzojnë çdo dërgesë te karburantit i cili dështon ne përmbushjen e specifikimeve minimale te cilësisë te përcaktuara ne këtë specifikim teknik dhe udhëzuesit/vendimet në fuqi të institucioneve kompetente, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin dhe AQP-ne,
Cilësia furnizimeve	e	16.2	Për furnizimin me karburante Autoritetet Kontraktuese te specifikuara ne Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim te përkohshëm. Pasi qe te shkarkohen karburantet në rezervuarët e gjeneratorëve te Autoriteteve

		Kontraktuese, ne nxejmje. dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Furnizuesi duhet të kryejë inspektimin e kontrollit të cilësisë së produkteve të ofruara dhe do të dorëzojë ato tek AK-ese të specifikuar në Aneksin 7 në përputhje me procedurat, standardet dhe frekuencat e rekomanduara të cilat zakonisht zbatohen në industrinë e naftës. Kurdo që bëhet dërgesa e karburanteve tek AK secila cistern duhet të jetë e shoqëruar me një Certifikatë të Kualitetit të lëshuar nga një institucion kompetent Testimi i cilësisë së karburanteve mund të bëhet kohë pas kohe dhe për testimin deri në dy (2) herë brenda vitit, shpenzime që do të shfaqen gjatë testimit të karburanteve do të kompensohen nga kontraktuesi pavarësisht rezultatit të testeve, ndërsa nëse kërkohet analiza të cilësisë me shumë se dy (2) herë shpenzimet të bartë pala që është fajtores. Shpenzimet që do të shfaqen gjatë inspektimit të karburanteve do të kompensohen nga Furnizuesi.
Pagesat	18	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 për karburantet në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake. Kërkesat për pagesë do të bëhet vetëm për karburantet në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit të faturave. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzojë tek secili AK i specifikuar në Aneksin 7 një faturë origjinale dhe një kopje për karburantet të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë të informacionin e nevojshme. Rishikimi i Çmimit: Çmimet e karburanteve të specifikuar në Listën e çmimeve do të përditësohet duke marrë parasysh elementet e mëposhtme: Referoju pjesës C, Seksioni II, Lista e Çmimeve dhe Aneksi nr. 10 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka qasje në berze dhe bene kalkulimin e çmimit në baza mujore duke u bazuar në Aneksin nr. 10 Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve. Autoriteti Kontraktues-Agjencia Qendrore e Prokurimit me së largu deri në datën pesë (5) të muajt vijues dërgon të Furnizuesi kalkulimin e çmimeve për muajin paraprak. Obligohet Furnizuesi që me së largu deri në datën dhjetë (10) të muajt vijues të dërgojë të gjitha faturat për shpenzimet e karburanteve për muajin paraprak të Autoritetit Kontraktues që shfrytëzojnë kontratën të specifikuar në Aneksin 7. Agjencia Qendrore e Prokurimit, vendimin e formimit të çmimeve të karburanteve për çdo muaj do ta publikojë në ueb faqen e AQP-se. Këtë vendim të formimit të çmimeve të publikuar në ueb faqen e AQP-se kanë të drejtë ta shfrytëzojnë vetëm Furnizuesi sipas kushteve të kësaj kontrate dhe Autoritetet Kontraktuese që janë shfrytëzues të kësaj kontrate kornize dhe janë të specifikuar në Aneksin nr. 7.

		Nuk lejohet nga asnjë Autoritet Kontraktues tjetër në Kosove që ta përdorin këtë Vendim të formimit të çmimeve.
Vonesa në pagesa	18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit.
Raportimi pranë AQP-së		Në rast se kërkohet nga AQP-ja, Autoriteti kontraktues obligohet të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasi të karburanteve të pranuar nga Kontraktuesi - Furnizuesi. Raporti duhet të paraqesë: Sasinë e karburanteve të pranuar për periudhën e kërkuar Llojin e karburantit; Sasia në litër Datën e pranimi të faturave; Datën e pagesave;
Dorëzimi	19.3	Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të karburantit nga ndonjë shkak do të jete mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur karburanti të dorëzohet në pronësi të AK apo në rezervuarët e gjeneratorëve dhe nxehmjeve të autorizuar të AK. Paketimin dhe shënimi: Paketimi dhe shënimi duhet të jetë në përputhje me procedurat dhe standardet e aplikuara në industrinë e naftës. Lokacionet e Autoriteteve Kontraktuese Vendndodhjet e Gjeneratorëve, rezervarëve të naftës për nxehje janë tek AK e specifikuar në Aneks 11. AK rezervon të drejtën të shtojë gjenerator të tjerë apo lokacione të tjera për furnizim me karburante në çfarëdo kohe gjatë periudhës së Kontratës. OE do të njoftohet paraprakisht me shkrim për lokacionin e ri minimum 48 orë para kërkesës fillestare. Njëjtë, AK rezervon të drejtën të largojë nga lista disa gjenerator ose rezervuarë naftës për ngrohje për të cilët nuk kërkohet me furnizim. Dorëzimi i karburantit: Afati kohor për dorëzimin e karburantit në pikat e Autoriteteve Kontraktuese është 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e cilitdo Autoriteti Kontraktues të specifikuar në Aneksin 7. Anulimi i porosisë së dorëzimit: Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim të karburanteve me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.
Verifikimi i operimeve	20	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
	20.1	Në rastet kur kërkohet testimi furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara. Inspektimet dhe testet do të realizohen në mostrat të cilat do të merren nga furnizimet para shprehjes

		në rezervuarët e AK-se apo në pikat e dorëzimit të kontraktuesit, mostrat duhet të merren në praninë e zyrtarëve përgjegjës të AK dhe kontraktuesit.
Pranimi përkohshëm	i 21	Për furnizim me karburante Autoritetet Kontraktuese të specifikuarane Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.
Obligimet garancionit	e 22.1	Furnizuesi garanton që furnizimet janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara, udhëzimet e institucioneve kompetente që janë në fuqi përfshirë edhe vendimet. Furnizuesi garanton që furnizimet nuk kanë asnjë defekt sasior apo cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve, Furnizuesi do të bëjë zëvendësimin e menjëhershëm të karburanteve të liferuara, ndërsa për karburantet që nuk përmbushin cilësinë do të njoftohen organet kompetente dhe do të veprohet sipas udhëzimeve të tyre. Në rast të defekteve apo mosfunksionimit normal të pajisjeve apo impianteve të Autoritetit Kontraktues, të shkaktuara nga cilësia e dobët e furnizimeve (karburanteve), Furnizuesi është i obliguar që të bëjë kompensimin total të dëmeve të shkaktuara nga cilësia jo adekuate e furnizimeve. Sidoqoftë, Furnizuesi duhet të siguroj se të gjithë njehsorët nëpër pikat e karburantit dhe auto-cisternat (vetanake apo të nën-kontraktuar) janë në pajtueshmëri të plotë me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë. Kjo nënkupton, se të gjithë njehsorët e lartcekur duhet të kenë kaluar testin e saktësisë.
Ndërprerja Kontratës Autoriteti kontraktues	e nga 26	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Ndërprerja Kontratës Furnizuesi	e nga 27	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues - AQP-se, të zyrtarëve përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të Furnizuesit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Prokurimi: UA/2016-22-3398-1-1-1

Nr i brendshëm: AQP-20-005-111

Tituli: Furnizim me karburante – Niveli Qendror

- | | |
|---|--|
| 1 | Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës |
| 3 | Lot 3 - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së |
| 4 | Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehtësi gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror |

Kodi i tenderit: 003/2022

Data: 13.06.2022

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1. Deklarata nen betim.pdf
2.	2. Çertifikat e Biznesit Fer Petroll.pdf
3.	3. Licencat Fer Petrol.pdf
4.	4. Qarkullimi Financiare per 3 vite.pdf
5.	6. Lista e Referencave-Referenca AQP.pdf
6.	7. Referencat-Verlindi-Adelina Shaljami BI-Goldingu-Progresi.pdf
7.	7.1 Referencat- Minerali-Fatosi shpk-Albi trans.pdf
8.	7.2 Reference Sallahu-Ilea-Rec Kos.pdf
9.	7.3 Referencat Erti shpk-Er Com- BHF Transport.pdf
10.	8. Lista e makineris.pdf
11.	10. Specifikimet teknike-Deklarata-Analiza.pdf
12.	11. Autorizimi Visari.pdf
13.	7.4 Referenca Diellza Transport.pdf
14.	9. Lista e nen Kontraktorve Deklaratat nen betim.pdf
15.	Pjesa 1.pdf
16.	Pjesa 3.pdf
17.	Pjesa 4.pdf
18.	12. Lista e çmimeve.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës	LISTA E ÇMIMEVE Lot 1.xlsx
2.	Lot 3 - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së	LISTA E ÇMIMEVE Lot 3.xlsx

3. Lot 4 - Furnizim me
karburante për nxehmje
gjenerator për nevojat e
institucioneve të Nivelit
Qendror

LISTA E ÇMIMEVE Lot 4.xlsx

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

Agjencia Qendrore e Prokurimit , Nderresa e Germis, 10000, Prishtinë,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: UA/2016-22-3398-1-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: N.T. „Fer-Petroll, Terstenik-Glllogoc, 13000, Glllogoc, Kosovë

E-mail: fer-petroll@hotmail.com

Personi kontaktues: Visar Thaqi

Telefoni: 045/569495

Faxi:

Numri fiskal: 810247967

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: UA/2016-22-3398-1-1-1

Titulli i kontratës: Furnizim me karburante – Niveli Qendror

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

4 Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror

3. Çmimi total i tenderit është:

2 976 473,58 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

LISTA E ÇMIMEVE

Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator për nevojat e Institucioneve publike të Nivelit Qendror

NR.	Pershkrimi	Naft – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme	BENZIN – sipas Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$	1,143.4348	1,081.5652
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (varlabile)	0.9076	0.9076
3	Çmimi i tonit ne Euro (3=1x2)	1,037.7393	981.5887
4	Shndërrimi i tonit ne litër (fiks)	1,191	1,368
5	Çmimi për litër ne euro (5=3/4)	0.8713	0.7175
6	Akciza për litër (fiks)	0.3600	0.3850
7	GJITHSEJ (7=5+6)	1.2313	1.1025
8*	Premiumi i kompanisë për 1 litër *	0.0299	0.0299
9	Gjithsej çmimi me Premium (9=7+8)	1.2612	1.1324
10	TVSH 18% / litër (10=9x18%)	0.2270	0.2038
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	1.4882	1.3363
12	Totali i litrave	2,000,000	0
13	Çmimi total i ofertes (13=11x12)	2,976,473.58	-
Totali		2976473.58	

Vërejtje/Sqarim: Ofertuesi duhet te plotesoj vetem kolonen 8 dhe çmimi total do te llogaritet sipas formule

- Premiumi për litër lejohet te shënohet me maksimum katër (4) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te katërt (4) nuk do te merret për bazë në llogaritje të vlerës se ofertës.
- Premiumi për litër do të jetë i pandryshuar gjatë tërë afatit të vlefshmërisë se kontratës dhe do te llogaritet sipas premimeve te dhëna nga Operatori Ekonomik për llojet e karburanteve ne Pjesa LISTA E ÇMIMEVE - kolona – 8 per naft ndersa per benzin nese do te kete gjate realizimit te kontrates do te kalkulohet me vleren e njejt si tek Nafta sipas formule se dhene per Benzin
- Çmimet për faturim te KARBURANTEVE do te llogariten nga Agjencia Qendrore e Prokurimit ne baza mujore dhe do te formohen sipas te dhënave te pasqyruara në Tabelë që është formuar sipas Aneksit 10 te dosjes së
- Bazë për vendosjen e vlerave në tabelë është çmimi sipas berzës (formulës) të Muajit Mars 2022 (duke rrumbullaksuar vlerat me 4 numra pas presës dhjetore

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i OE:	N.T FER PETROL
Emri dhe mblemri i perfaqesuesit te OE:	Visar Thaqi
Nenshkrimi:	
Data:	13.06.2022
Vula:	



Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PARATHENIE

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese;
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, ndihmon në kryerjen e aktivitetëve të prokurimit.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 15/67 të datës 09.03.2022 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, miratuar në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. AQP është autorizuar që të fillojë me procedurat qendrore për Furnizim me Karburante në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese Aneksin nr. 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me Karburante për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me karburante Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit me karburante për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7, duke përfshirë:

- a) importimin e karburanteve;
- b) shpërndarjen e karburanteve në të gjithë territorin e Kosovës;
- c) shkarkimin e karburantit në automjete, gjeneratorë, rezervarë të nxehjes.

Karburante do të thotë naftë dhe benzinë.

Specifikimi teknik për Naftë për vetura, gjenerator, nxehje dhe mjete tjera levizëse dhe për Benzinë duhet të jetë në harmoni me udhëzuesin administrativ (MTI) nr.09/2020 për Kontrollin dhe Cilësinë e Karburanteve të lëngëta të Naftës të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Çdo ndryshim i ardhshëm i cilësisë së karburanteve me ndonjë Udhëzim nga MTI apo ndonjë Institucion që autorizohet me ligj që ta bëjë këtë, do të jetë obligues për furnizuesin gjatë realizimit të Kontratës. Për çdo liferim të karburanteve që nuk janë në harmoni me udhëzuesin e lartecukur AK duhet të informojë organet kompetente dhe kontraktuesi do të mbajë përgjegjësinë

Për Lot 1 dhe Lot 2 furnizimi do të jetë me Naftë dhe Benzinë për vetura, Lot 3 do të jetë për vetura por AK-FSK mund të përdorë edhe për nevoja tjera ndërsa në Lot 4 furnizimi me karburante do të jetë për nxehje dhe gjenerator apo nevoja tjera të AK-se.

Sasia e përafërt e karburanteve:

Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror

Nr.	Pershkrimi	Njesia masese	Sasia e perafert per 12 muaj
1	Naft / (Benzin)*	litër	2,000,000

***Lot 4 nuk parashihet të ketë sasi të Benzin, por në rast se ndonjërit nga AK-se do ti lind nevoja për Benzin atëherë çmimi do të kalkulohet sipas formulës të paraqitur në Aneks 10 për Benzin me premiumin në vlerë të njëjt me atë të Diesel.**

Per Lot 4 Afati kohor për dorëzimin e karburantit në pikat e shpërndarjes së autoriteteve kontraktuese është 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga cilitdo Autoriteti Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 dhe Aneksin 11 por gjithashtu Autoritetet tjerë Kontraktuese mund të shtohen gjatë implementimit të kontratës, sasia minimale e porosisë për derivate për nxehmje do të jetë të paktën 50% e kapaciteteve të rezervuarëve të AK përveç rasteve të veçanta kur AK ka arsye objektive për porosi të sasive më të vogla ndërsa porosia për derivate për gjenerator dhe nevoja tjera do të jetë sipas nevojave të AK-se.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të karburantit nga ndonjë shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur karburantit dorëzohet në pronësi të AK apo në rezervuarët e automjeteve dhe gjeneratorëve të autorizuar të AK.

AK të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin, çdo dërgesë të karburantit i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik dhe udhëzuesit në fuqi nga organet kompetente.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës do të shpërndajë kontratën tek secili Autoritet Kontraktues të identifikuar në Aneksin 7 dhe do ta publikojë në webfaqen e AQP-së dhe në e-prokurim.

Secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 7 (shtatë) ditëve, pas pranimit të kontratës së nënshkruar nga AQP, është i obliguar që të dorëzojë tek Operatori Ekonomik një listë të veturave (me numra të regjistrimit) të autorizuar për furnizim me karburante në pompat e Operatorit Ekonomik. Një listë e tillë mund të freskohet kohe pas kohe nga ana e AK-ese. Një listë e tillë do të jetë efektive vetëm pas 24 orësh pas datës dhe kohës së marrjes së një listë të tillë nga ana e Operatorit Ekonomik.

OE, në koston dhe shpenzimet e tij, do të instalojë matës (metra) në automjetet e karburantit në mënyrë që të regjistrojë me saktësi sasinë e karburantit të dorëzuar në rezervuarët e AK-ve. Këta matës duhet të kalibrohen dhe të jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe standardet e industrisë. Periodikisht, AK-ese të specifikuara në Aneksin 7 ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar mund të inspektojnë dhe testojnë matësit e tillë. Do të kërkohet nga OE të rikalibrojë matësit e tij për të eliminuar ndonjë mospërputhje në mes leximeve të njehsorëve të OE dhe rezultateve të inspektimit të AK-ese.

Kërkohet nga OE që të marrë nënshkrimet e pranimit të karburanteve / të lëshojë kuponin e karburantit dhe/apo fletën e të dhënave nga i gjithë personeli i autorizuar të cilët marrin karburantet për përdorim në automjete, gjeneratorë. Nevojiten të dhënat në vijim:

- Data dhe koha e lëshimit
- Emri i entitetit, departamentit, seksionit, njësisë pranuese
- Emri dhe numri i identifikimit të individit që pranon shërbimin
- Lloji i karburantit të marrë
- Barkodin e gjeneratorit, numrin serik dhe lexuesin e "orëve të punës" (kurdo që është i pajisur ose

- Në rastin e karburantit ne Kontenierë, destinacioninse ku është duke u dërguar dhe numrin e autorizimit
- Sasinë (në litra) te karburantit.

Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë ne dispozicion 24/7 dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar ne Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë fokale ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të jetë ne dispozicion 24/7 dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Kërkohet nga OE qe te dorëzoj karburantet dhe të mbush gjeneratorët dhe rezervarët e naftës për ngrohje te listuar në Aneksin 7. Përveç listës se specifikuar, AK-ese te specifikuara ne Aneksin 7 rezervojnë të drejtën të shtojnë gjenerator te tjerë apo lokacione te tjera për furnizim me karburante në çfarëdo kohe gjatë periudhës së Kontratës. OE do të njoftohet paraprakisht me shkrim për lokacionin e ri minimum 48 orë para kërkesës fillestare. Njëjte, AK-ese te specifikuara ne Aneksin 7 rezervojnë të drejtën të largojnë nga lista disa gjenerator ose rezervuarët naftës për ngrohje për te cilët nuk kërkohet me furnizim.

AK shfrytëzues të kontratës mund të kërkojnë 2 herë brenda një viti nga OE i kontraktuar analiza (me shpenzime të OE) të cilësisë së karburanteve nëse AQP pranon vërejtjeje në cilësinë e furnizimeve nga autoritetet shfrytëzuese të kontratës. Ne rast se AK qe janë ne aneksin 7 te kësaj kontrate kërkojnë analiza me shumë se siç është cekur me lartë shpenzimet do ti bart AK nëse rezultatet dalin qe janë brenda normave të lejuara dhe në rast se rezultatet janë jashtë normave të lejuara shpenzimet do ti bartë kontraktuesi.

Ankesi 7 LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE/NJESIVE KËRKUESE

Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	Administrata Tatimore e Kosovës
2	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
3	Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
4	Agjencia Kosovare e Privatizimit
5	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
6	Akademia e Kosovës për Sigurinë Publike
7	Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare
8	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
9	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
10	Doganat e Kosovës
11	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
12	Këshilli Prokurial i Kosovës
13	Komisioni i Pavarur për Media
14	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
15	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
16	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
17	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
18	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike
19	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
20	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
21	Parlamenti i Kosovës
22	Qendra e Studentëve
23	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
24	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
25	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
26	Shërbimi Korrektues i Kosovës
27	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"
28	Zyra Kombëtare e Auditimit
29	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Gjatë implementimit të kontratës mund të shtohen autoritete tjera nëse do të formohen gjatë kësaj kohe apo nëse kanë arsye të objektive për mungesën e tyre në Aneksin 7, në këto raste AQP do ju mundësojë shfrytëzimin e kontratës pas kërkesës së tyre dhe vlerësimit nga AQP-ja.

Aneksi 10 Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve

NR.	Pershkrimi	Diesel	Benzine	Fiks (F) /Varibal (V)
1	Berza mesatare mujore CIF Med (Genova/Lavera Ton/\$	1,143.4348	1,081.5652	V
2	Kursi mesatar mujor \$/euro (variabile)	0.9076	0.9076	V
3	Çmimi i tonit ne Euro (1X2)	1,037.7393	981.5887	V
4	Shëndrrimi i tonit ne litër (fiks)	1,191	1,191	F
				Nje (l)Ton diesel = 1 191 litra
				Nje (l) Ton benzin = 1 368 litra
5	Çmimi për litër ne euro (3/4) (Çmimi para taksave)	0.8713	0.7175	V
6	Akciza për litër (fiks)	0.3600	0.3600	Fiks sipas ATK dhe Doganës, mund të ndyrshoj vetëm nëse ndryshojn tarifat sipas ATK dhe Doganës/Qeveris
7	GJITHSEJ (5+6)	1.2313	1.1025	V
8	Premiumi i kompanisë / litër sipas ofertës dhe kontratës	-	-	F Këtu vendoset Premium/fitimi I OE te kontraktuar referoju shënimit te poshtëshënuar

9	Gjithësejt çmimi me Premium (7+8)	-	-	V
10	TVSH 18% / litër	-	-	Fiks 18% TVSh, kjo mund ndryshoj vetëm nëse ndryshon tarifat sipas ATK/Qeveris
11	Çmimi për litër për faturim (9+10)	-	-	V
Të dhënat e pasqyruara në tabele janë të marruar nga llogaritja e Çmimit të karburanteve për muajin Mars 2022. Kalkulimi i Çmimit gjate realizimit te kontrates behet duke u bazuar ne çmimin mesatar mujor te berzes se Plattit CIF Med (Genova/Lavera), kursit mesatar mujor te Bankes Qendrore Evropiane dhe elementeve tjera fikse dhe variabile qe janë pasqyruar ne Aneksin 10 - Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues te karburanteve.				
Shënim: Në nr. rendor 8 OE duhet të vendosin premiumin / fitimin e kompanisë duke llogaritur të gjitha shpenzimet që nuk janë paraparë më lartë në këtë tableë.				

SQARIM:

1. AQP para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës do të kërkoj një deklaratë me shkrim nga OE se do të mbajnë së paku 10% të sasisë të kontraktura si rezervë për implementimit e kontratës.
2. Nëse ka mospërputhje në mes Njoftimit të Kontratës dhe Dosjes së Tenderit (DT) si pasoj e platformës elektronike (çështjeve teknike) do të vlejë Dosja e Tenderit.

ANEKSI 11 Pikat e shpërndarjes se Autoriteteve Kontraktuese

Afati kohor për dorëzimin e karburantit në pikat e shpërndarjes se autoriteteve kontraktuese është 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga cilitdo Autoriteti Kontraktues i specifikuar më poshtë por gjithashtu Autoritetet tjerë Kontraktuese mund të shtohen gjatë implementimit të kontratës.

Lot 4 Furnizim me karburante për nxehmje/gjenerator për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror

Nr	Emri i Autoritetit Kontraktues
1	Administrata Tatimore e Kosovës
2	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
3	Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës
4	Agjencia Kosovare e Privatizimit
5	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
6	Akademia e Kosovës për Sigurinë Publike
7	Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare
8	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
9	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
10	Doganat e Kosovës
11	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
12	Këshilli Prokurial i Kosovës
13	Komisioni i Pavarur për Media
14	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
15	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
16	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
17	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
18	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike
19	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
20	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
21	Parlamenti i Kosovës
22	Qendra e Studentëve
23	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
24	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
25	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
26	Shërbimi Korrektues i Kosovës
27	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"
28	Zyra Kombëtare e Auditimit
29	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Shënim:

- ✓ Operatori Ekonomik duhet të sjell derivatet në rezervuarat e AK-së sipas porosive të AK.
- ✓ Kontraktuesi obligohet që secilin furnizim ta bëjë me autobot që kanë volumneter elektronik të kalibruar nga institucionet kompetente duke prezantuar certifikatën në secilin rast të furnizimeve. Menaxheret e kontratës nga secili AK që shfrytëzon këtë kontratë kanë përgjegjësi të sigurohen që sasia e dorëzuar të jetë e saktë. Nëse AK ka ne pronësi Volumneter elektronik të kalibruar mund ta përdorë gjatë furnizimit.



N.T FER PETROLL – Tërstenik-Drenas
NUI: 810247967
044/431/851

Datë: 16.08.2022


VENDIM

Per caktimin e menaxherit te kontrates LOT 4- FURNIZIM ME KARBURANTE
PER NXEMJE DHE GJENERATOR PER NEVOJA TE INSTITUCIONEVE TE
NIVELIT QENDROR Nr.Prok.: UA/2016-22-3398-111

Fidan Prokshi 049-717-944

Visar Thaqi 045-226-563

N.T FER PETROLL



Banka Kombetare Tregtare Kosove SH.A
Dega Skenderaj
Sheshi Adem Jashari
Skenderaj 41000, Kosovë
Protokol Nr.

Skenderaj: 20 Korrik 2022



Tipi i Garancisë: GARANCION PERFORMANCE

Nr. i Garancisë: 753GIPD222010001

Garantuesi: BANKA KOMBETARE TREGTARE KOSOVE SH.A.
Dega Skenderaj
Sheshi Adem Jashari

Aplikanti: N.T. „FER-PETROLL
Terstenik, 13000 Glllogoc, Kosovë

Përfituesi: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
Ndërtesa e ish-Gërmisë Kati IV zyra A 403, 10000 Prishtinë, Kosovë

Marrëveshja bazë: Furnizim me karburante për nxehmje dhe gjenerator për nevojat e institucioneve të nivelit qendror, nr. I kontratës UA/2016-22-3398-1-1-1/C251

Shuma dhe valuta e Garancisë: 297,648.00 EUR (Dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë e tetë EURO)

Çdo dokument shtesë i kërkuar si mbështetës për kërkesën për pagesë, përveç deklaratës që kërkohet në tekstin e LG mëposhtë: Nuk ka

Gjuha e dokumenteve: Gjuha e dokumentave do të jetë në gjuhën shqipe

Forma e prezantimit: Kërkesë për pagesë e firmosur nga firmat e autorizuar të Përfituesit. Kërkesa për pagesë duhet dërguar në adresën e përcaktuar më poshtë përpara ose në datën e maturitetit të Garancisë Bankare.

Vendi i prezantimit: BANKA KOMBETARE TREGTARE KOSOVE SH.A
Dega Skenderaj
Sheshi Adem Jashari

Skadencia: 13 Shtator 2023

Pala përgjegjëse për komisionet: Aplikanti

Si Garantues, ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme t'i paguajmë Përfituesit çdo shumë deri në Shumën e Garancisë përkundrejt prezantimit nga Përfituesi të kërkesës për pagesë në përputhje me kushtet e Garancisë, në formën e prezantimit të treguar më lart, mbështetur nga dokumente të tilla sic specifikuar më lart dhe në çdo rast nga Deklarata e Përfituesit, në kërkesë apo në një dokument të veçantë të nënshkruar që shoqëron ose identifikon kërkesën, ku tregohet në çfarë aspekti Aplikanti është në shkelje të detyrimeve të tij që rrjedhin nga Marrëveshja Bazë. Kërkesa e Përfituesit për pagesë dhe deklaratat përcjellëse me shkrim duhet të jenë të vulosura dhe të nënshkruara nga personi i autorizuar i Përfituesit.

Ky garancion nuk do të jetë më në fuqi dhe do të anulohet, nëse para datës së skadimit nga Përfituesi kthehet origjinali i këtij garancioni i shoqëruar me konfirmimin me shkrim të nënshkruar dhe vulosur nga Përfituesi përmes të cilit Përfituesi i Garancionit shprehimisht liron Garantuesin nga të gjitha obligimet dhe detyrimet e kësaj Garancie duke e konsideruar kështu të përfunduar.

Vlera e këtij garancioni mund të zvogëlohet, për çdo pagesë të kryer nga Garantuesi, sipas kërkesës së Përfituesit për pagesë.

Çdo kërkesë nën këtë Garanci duhet të merret nga ne në ose përpara Skadencës në Vending e prezantimit të specifikuar më lart.

Kjo Garanci është subjekt i Rregullave Uniforme për Garancitë me kërkesë (URDG) 2010 Revision, Publikimi i ICC Nr. 758.

BD

FE

Fatos Rushiti
Branch Manager



Berat Duraku
Asst. Specialist

